

VENDIM
Nr. 41, datë 29.1.2014

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MJEDISEVE, NGA KOMISIONERI
PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE, AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E
SHOQËRISË CIVILE DHE KOMITETI SHTETËROR I MINORITETEVE TE MINISTRIA E
ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të mjediseve, nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe Komiteti Shtetëror i Minoriteteve të Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, sipas planimeve bashkëlidhur këtij vendimi, për t’u përdorur si mjedise pune nga kjo ministri.

2. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 217, datë 2.2.2009 “Për dhënien në përdorim Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të një pjese të ndërtesës së ish-Ministrisë së Transporteve e Telekomunikacioneve”, nr. 223, datë 7.4.2010 “Për dhënien në përdorim Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile të disa mjediseve të ndërtesës së ish-Ministrisë së Transporteve e Telekomunikacioneve”, dhe nr. 249, datë 13.4.2010 “Për dhënien në përdorim Komitetit Shtetëror të Minoriteteve të disa mjediseve të ndërtesës së ish-Ministrisë së Transporteve e Telekomunikacioneve”, shfuqizohen.

3. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, Komiteti Shtetëror i Minoriteteve dhe kryeregjistruesi i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama




PLANIMETRIA E KATIT TE PARE Ekzistuese



LEGJENDA

 KOMISIONERI PER MBROJTJEN E TE DHENAVE PERSONALE



PLANIMETRIA E KATIT TE TRETE - Ekzistuese (Shtesa)



LEGJENDA

	AGJENSIA PER MBROHTTET E SHQËRIMIN CIVIL
	KOMITETI SHQËRIMOR I MINORITETEVE